

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ON TOP ALBANIA " Sh.p.k.**

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë; **ALBANIA**
- Shoqëri është Shoqëria "**ON TOP**" Sh.p.k.

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1**

**DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

1. Sot, më datë **29.07.2020** në themeluesit kemi krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**ON TOP**" Sh.p.k.
2. Themeluesit e Shoqërisë "**ON TOP ALBANIA**" Sh.p.k. janë:

Z./Znj. **Seliana Kumurija** i/e datëlindjes **07.05.1986**, lindur në **Tirane** dhe banues në **Tirane** mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal **I60507065I**

Z./Znj. **Etland Hoxha** i/e datëlindjes **09.10.1984**, lindur në **Tropoje** dhe banues në **Tirane** mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal **I41009002W**

Z./Znj. **Reoli Koçi** i/e datëlindjes **03.06.1988**, lindur në **Shkollë** dhe banues në **Tirane** mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal **I80603068R**

**NENI 2**


**OBJEKTI**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

"**Auto servis, Lyrje automjesh. BAR CAFE**  
**SHITJE BLENDJE, QERA, MAKINASH, SHITJE**  
**PËSESË MAKINASH**"

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**



Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afakt të pa përcaktuar.

#### NENI 4

#### SELIA

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:  
" Peze - Helmes Tirane " 2. Kanalestrale Nr. 2953

#### KREU II KAPITALI

#### NENI 5

#### KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është njëzet mijë (në fjalë). lekë
2. Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Z/Znj, i/e bija/biri e S. Kumurija datëlindjes 07.05.1986 lindur në Tirane dhe banues në Tirane mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal IG0507065I është zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme dhjetë mijë (në fjalë) lekë, që përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Z/Znj, i/e bija/biri e E. Hoxha datëlindjes 09.10.1984 lindur në Tropoje dhe banues në Tirane mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal T41009002W është zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme pesë mijë (në fjalë) lekë, që përbën 25 % të kapitalit të shoqërisë.

Z/Znj, i/e bija/biri e R. Koçi i/e datëlindjes 03.06.1988 lindur në Shkodër dhe banues në Tirane mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal T80603068R është zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme pesë mijë (në fjalë) lekë, që përbën 25 % të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 6

#### ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit



- nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
  3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
  4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **NENI 7**

### **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

## **NENI 8**

### **ORGANI VENDIMARRËS**

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërise. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.
2. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

HOXHA

- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## NENI 9

### MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## NENI 10

### KUORUMI

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se

gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblihet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblihet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **NENI 11**

### **MARRJA E VENDIMEVE**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
3. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **NENI 12**

### **PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## NENI 13

### ADMINISTRIMI

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
2. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
5. Z/Zipj, i/e bija/biri e E. Hoxha i/e datëlindjes 09.10.1984 lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë mbajtës e letërnjoftimit me Nr. Personal I41009002W është administrator i parë i shoqërisë me afat emërimi nga data 29.07.2024 deri më datë 29.07.2025

### Nënshkrimi

(emer mbiemer firme)

Etland Hoxha 

## NENI 14

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
  - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryenë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të therrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:



- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
  4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
  5. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 15

### PERGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me

HOXHA

përrjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

6. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

7. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

8. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

9. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

### NENI 16

#### VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

### NENI 17

#### EKSPERTËT

1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.



2. Në perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezohë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar.

## KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

### NENI 18

#### PRISHJA DHE LIKUIDIMI

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në çdo kohë :
  - a) me vendim të Asamblese se Ortakeve
  - b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; i ndryshuar me ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”
  - d) me vendim të gjykatës;
2. Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqeri në likuidim e sipër”.
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
4. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### NENI 19

#### RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

### NENI 20

#### BAZA LIGJORE

FOXHA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 21

### MOSMARRËVESHJET

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e shkallës së parë Tirane

### ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR:

Z/Znj

Selvan Kukurija

(emër, mbiemër, firmë)



Z/Znj

Etland Hoxha

(emër, mbiemër, firmë)

Z/Znj

Redi Hoxhi

(emër, mbiemër, firmë)

